

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegjii i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Valdete Daka, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit V. Z., nga komuna e Istogut, për shkak të 16 veprave penale të vjedhjes së pyllit nga neni 285 par. 2 të KPK dhe 16 vepra penale të vjedhjes së pyllit nga neni 285 par. 1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Pejë, P.nr. 16/2015 datë 11.11.2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn.nr. 659/2015 datë 18.12.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 9 mars 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit V. Z., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Pejë, P.nr. 16/2015 datë 11.11.2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn.nr. 659/2015 datë 18.12.2015.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin Pn.nr. 16/2015 datë 11.11.2015, Gjykata Themelore Pejë ka refuzuar kërkesën e të dënuarit V. Z. për zëvendësimin e dënimit me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

Duke vendosur sipas ankesës së të dënuarit Gjykata e Apelit me aktvendimin e saj Pn.nr. 659/2015 datë 18.12.2015, e ka refuzuar ankesën e të dënuarit ndërsa aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr. 27/2016 datë 18.2.2016, ka dhënë përgjigjen në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, i dënuari V. Z. ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë duke theksuar se është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit për faktin se nuk është bërë zëvendësimi i dënimit me burgim me urdhër për punë në dobi të përgjithshme siç është paraparë me dispozitën e nenit 60 të KPK, meqë janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë nga këto arsye:

Siç rezulton nga shkresat e çështjes me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Pejë – Dega në Istog, P.nr. 305/2012 datë 14.1.2015, i dënuari V. Z., është shpallur fajtor për shkak të 16 veprave penale të vjedhjes së pyllit nga neni 285 par. 2 të KPK dhe 16 vepra penale të vjedhjes së pyllit nga neni 285 par. 1 të KPK dhe pasi që më parë i janë përcaktuar dënimet për secilën vepër veç e veç, është gjykuar me dënim me gjobë unik në shumë prej 5.400 €, të cilin dënim duhet ta paguajë në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën ky dënim do t'i shëndrohet në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 270 (dyqindeshtatëdhjetë) ditësh, ku për një ditë burgim i llogaritet 20 € të gjobës. Është detyruar që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 400 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara ..... zyra në Istog, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr. 174/2015 datë 20.3.2015, kur edhe aktgjykimi e ka marrë formën e prerë.

Pasi që aktgjykimi ka marrë formën e prerë, më datë 27.4.2015, gjykata ka lëshuar urdhëresë për ekzekutimin e dënimit me gjobë, të cilën i dënuari në asnjë moment nuk e ka kundërshtuar e as që e ka kundërshtuar mënyrën e pagesës apo që ka paraqitur ndonjë kërkesë që dënimi i shqiptuar të ekzekutohet me këste apo ndonjë mënyrë tjetër.

Meqë i dënuari dënimin me gjobë nuk e ka paguar në afatin e urdhëruar nga gjykata, Gjykata Themelore Pejë – Dega në Istog, me aktvendimin P.nr. 305/2012 datë 30.7.2015, ka marrë aktvendimin mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë prej 5.400 € në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 270 (dyqindeshtatëdhjetë) ditësh.

Më pas i dënuari me një parashtrësë ka kërkuar nga gjykata që dënimi i shqiptuar-zëvendësuar nga dënimi me gjobë, në dënimin me burgim, tani t'i zëvendësohet me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin Pn.nr. 16/2015 datë 11.11.2015, ka refuzuar kërkesën e të dënuarit i cili aktvendim është konfirmuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn.nr. 662/2015 datë 18.12.2015.

Gjykata Supreme vlerëson se pretendimi i të dënuarit se është shkelur ligji penal në dëm të tij është i pabazuar për faktin se konform dispozitave të nenit 47 dhe 48 të KPK, është i mundshëm zëvendësimi i dënimit me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj, me dënimin me gjobë ose me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, por vetëm me pëlqimin e të dënuarit. Është e qartë se kjo është mundësi e jo imperativ ligjor mirëpo, duke pasur parasysh veprat penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor dhe dënimi i paraparë për këto vepra penale, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit është e drejtë diskrecionale e gjykatës që të vlerësojë me çfarë dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga dispozita e nenit 41 të KPK. Sipas dispozitave të lartë cekur, kemi të bëjmë me zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë respektivisht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

Është evidente se në rastin konkret të dënuarit me aktgjykimin e shkallës së parë i cili është konfirmuar nga Gjykata e shkallës së dytë, është shqiptuar dënimi i me gjobë në shumë prej 5.400 €.

Sipas dispozitës 60 të KPK, në të cilën thirret i dënuari, Gjykata mund t'ia shqiptoj personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryerësit i shqipton dënim me gjobë deri në 2.500 € ose me burgim deri në 1 (një) vit. Mirëpo, ku zëvendësim mund të bëhet vetëm me rastin e caktimit të dënimit. Në rastin konkret duke pasur parasysh dënimin e shqiptuar me gjobë në shumë prej 5.400 € në asnjë variant të dënuarit gjykata nuk ka mundur t'ia shqiptoj dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. As dënimi me burgim i cili të dënuarit i është zëvendësuar pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit (si pasojë e mos pagesës së dënimit me gjobë), në asnjë mënyrë nuk mund të zëvendësohet me urdhër për punë në dobi të përgjithshme në këtë fazë të procedurës. Në një situatë të këtillë, dënimi me burgim (i zëvendësuar nga ai me gjobë), mundë të zëvendësohet, vetëm atëherë nëse paguhet gjoba, meqë i dënuari në çdo kohë mund ta bëjë një gjë të tillë.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.39/2016, më 9 mars 2016

Procesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Avdi Dinaj